

Disa fjalë rreth Monitorit

E kemi vërejtur që deri më tani ka ekzistuar një mundësi reale që Qeveria të marrë vendime të rëndësishme mbi çështje të ndryshme pa u vënë re nga publiku kosovar. Arsyet për këtë qëndrojnë në mungesën e informimit të plotë përmes botimeve qeveritare, mungesën e monitorimit të deritashëm të vendimeve nga ndonjë OJQ dhe mungesën e hapësirës që u jepet vendimeve të Qeverisë në media.

Që kjo të mos ndodhë më, kemi vendosur që çdo muaj, përmes GAP Monitorit të vendimeve të Qeverisë,

të raportojmë më në detaje mbi të gjitha vendimet e Qeverisë së Kosovës. Këtë do ta bëjmë jo vetëm duke ju informuar mbi titujt e vendimeve që janë marrë gjatë muajit, por duke u thelluar pak më shumë në secilin prej tyre, për ta analizuar arsyeshmërinë, historikun dhe ligjshmërinë e secilit vendim. E kjo nuk përfundon me kaq: ne gjithashtu do të mundohemi që secilin vendim të marrë nga Qeveria ta përcjellim deri në zbatim dhe të raportojmë mbi problemet apo ngecjet eventuale.

E gjithë kjo në përpjekje të

përhershme që ta ngushtojmë hendekun në mes qeverisjes dhe qytetarëve të Kosovës.

Gjatë muajit janar, në mes tjerash, janë vërejtur ngecje të implementimit të vendimeve të mëhershme, vonesa në implementimin e ligjeve dhe probleme në ndarjen e pushtetit. Për të gjitha këto mund të lexoni në vijim.

Lexim të këndshëm,

Instituti për Studime të Avancuara
GAP



Përkundër refuzimit nga Kuvendi, Qeveria merr vendim për plotësimin e pozitave të lira në KELP

Në mbledhjen e 50 të Qeverisë së Kosovës, të mbajtur më 16 janar 2009, u mor vendimi (nr.02/50) për plotësimin e pozitave të lira në Komisionin për emërimet të Larta Publike (KELP), pozita këto të mbetura pas tërheqjes së anëtarëve ndërkombëtarë nga ky komision. Ky vendim merret me qëllim të funksionimit të duhur dhe efektiv të KELP-it, deri në pritje të finalizimit dhe hyrjes në fuqi të ligjeve të Kuvendit të Kosovës mbi organizimin e Shërbimit Civil të Kosovës, përfshirë edhe emërimin e zyrtarëve të lartë.

Statusi i KELP-it për herë të parë është definuar me Rregulloren e UNMIK-ut nr.2001/19 mbi Degën e Ekzekutivit të IPVQ-ve. Sipas shtojcës 1, paragrafit E të kësaj rregulloreje, ky komision do të kryesohej nga Kryeministri, kurse në përbërje do të ketë Ministrin e Shërbimeve Publike, dy ministra nga radhët e komuniteteve pakicë, tre persona të pavarur eminentë dhe tre ndërkombëtarë. Detyra e KELP-it, sipas kësaj rregulloreje, ishte emërimi i sekretarëve të përhershëm të ministrive, emërimi i nëpunësve kryesorë ekzekutivë të Agjencive Ekzekutive dhe emërimi i individëve në poste të tjera, për të cilat do të vendoste PSSP-ja.

Funksionet e KELP-it definohen edhe më qartë me Rregulloren e UNMIK-ut nr.2001/36 mbi Shërbimin Civil të Kosovës. Sipas kësaj rregulloreje, tre anëtarët ndërkombëtarë dhe tre anëtarët eminentë të Kosovës

përzgjidhen nga PSSP-ja. Për çdo post vakant në postet e larta në kuadër të shërbimit civil të Kosovës duhet të shpallet konkurs, kurse juria do të jetë e përbërë nga Sekretari i Përhershëm i MSHP-së, ai i ministrisë në të cilën do të shërbejë kandidati, një anëtar ndërkombëtar dhe një anëtar eminent në përbërje të KELP-it. Kjo juri i përcakton kriteret për intervistim dhe në bazë të intervistave harton një listë prej tre emrave, të cilët ia rekomandon KELP-it për ta përzgjedhur njërin prej tyre.

Qeveria me vendimin nr.02/50 vendosi që të zëvendësojë anëtarët e KELP-it pa marrë parasysh vendimin e Kuvendit dhe pa pritur Ligjin për shërbimin civil.

Më 14 nëntor 2008, Qeveria përmes vendimit nr.5/45 i propozon Kuvendit të Kosovës që ta miratojë një marrëveshje, sipas së cilës tre përfaqësuesit ndërkombëtarë të KELP-it do të zëvendësoheshin me tre përfaqësues eminentë kosovarë, me ç'rast numri i anëtarëve të pavarur eminentë do të rritej në gjashtë. Këta gjashtë kandidatë do t'i propozonte Kryeministri dhe emëronte Presidenti. Sipas këtij propozimi, do të zëvendësoheshin aktet juridike të gjertanishme (Rregullorja e UNMIK-ut nr.2001/19 dhe 2001/36), deri në miratimin e legjislacionit të ri nga ana e Kuvendit të Kosovës që do të

rregullonte punën e emërimeve të larta publike. Megjithatë, Kryesia e Kuvendit të Kosovës në mbledhjen e 24 nëntorit 2008 nuk e mbështeti kërkesën e Qeverisë për emërimet në KELP, me arsyetimin se për këtë duhet të pritet ligji.

Përkundër refuzimit të Kuvendit të Kosovës, Qeveria me vendimin nr.02/50 prapëseprapë vendosi që t'i zëvendësojë anëtarët e KELP-it, pa marrë parasysh vendimin e Kuvendit dhe pa e pritur Ligjin mbi Shërbimin Civil. Ky vendim ndikon në politizimin e administratës ngase përzgjedhje e përfaqësuesve të KELP-it do të varet nga vullneti i Kryeministrit dhe Presidentit, e që njëherit janë edhe liderë të dy partive kryesore qeverisëse. Ndryshimi me vendim ekzekutiv i një ligji në fuqi, paraqet përzjerje të degës së ekzekutivit ndaj asaj të legjislativit.

Me gjithë Strategjinë Legjislative 2009, e cila thekson se Projektligji për Shërbimin Civil dhe Projektligji për Pagat e Nëpunësve Civil duhet të arrijnë në Kuvend në fillim të vitit, pasi që janë në fazën e grupeve punuese, një gjë e tillë ende nuk ka ndodhur. Këto dy ligje, si dhe Ligji për Pagat e Zyrtarëve të Lartë Publikë, i cili pritet të arrijë në Kuvend, në qershor 2009, do të rregullojnë edhe statusin e ri të KELP-it. Nga 17 ministri sa ka Qeveria e Kosovës, në 12 prej tyre postin e Sekretarit të Përhershëm e ushtrojnë personat e caktuar si ushtrues detyre dhe që të gjithë janë të emëruar politikë nga ana e ministrave.

Nga 1 janari 2009 pagat e pensionistëve dhe ndihmat sociale rriten për 5 €, pagat e shërbyesve civilë rriten për 10%

Nga 1 janari 2009, Qeveria ka rritur për 5 € ndihmat për këto kategori të skemave pensionale dhe sociale në kuadër të Ministrisë së Punës dhe Mirëqenies Sociale (MPMS): Skema e Pensioneve Bazë, Skema e Pensioneve Kontribut-Pagues, Skema e Pensioneve të Aftësisë së Kufizuar dhe Skema e Asistencës

Sociale. Ky vendim ka filluar të zbatohet nga marsi 2009, por me pagesë retroaktive nga 1 janari. Tani përfituesit e pensioneve bazë marrin 45 € në muaj, pensionistët kontribut pagues marrin 80 €, përfituesit e skemës të pensionit të aftësisë së kufizuar do të marrin nga 45 €, kurse përfituesit e skemës së ndihmës

sociale të cilët kanë marrë ndihma nga 35€ deri 75€, do të marrin 5 € shtesë, varësisht prej kategorisë së ndihmës që marrin.

Përveç kësaj, nga 1 janari 2009 Qeveria ka rritur për 10% pagat (vazhdon në fund të faqes 3)

Vendoset që Zyra për Komunitete pranë Kryeministrit të rekrutojë personel shtesë

Dy ditë para shpalljes së Pavarësisë së Kosovës, më 15 shkurt 2008, në Qendrën Mediale, të hapur në Hotel Grand, Kryeministri kishte paralajmëruar një Konferencë për Media. Mediat botërore, si CNN dhe BBC, i kishin ndërprerë programet e tyre, duke u lidhur drejtpërdrejt me Prishtinën, me shpresë se Kryeministri Thaçi do ta jepte lajmin për shpalljen e Pavarësisë së Kosovës. Mirëpo, në atë konferencë për media, Kryeministri njoftoi mediat për vendimin e tij se në kuadër të zyrës së tij do të hapej një zyrë e re për çështje të komuniteteve.

Që nga ajo kohë kanë kaluar një vit dhe, përveç se është caktuar udhëheqësi i saj, nuk është bërë asgjë në drejtim të funksionalizimit dhe përcaktimit të detyrave të kësaj zyre. Sipas organogramit të paraqitur nga Zyra për Çështje të Komuniteteve për punësim të

personelit shtesë, kërkesë e cila është aprovuar me vendimin 03/49 të Qeverisë, parashihet punësimi i 7 personave në këto pozita: Këshilltar i Lartë (drejtor), Zyrtar i

Kanë kaluar një vit dhe, përveç se është caktuar udhëheqësi i saj, nuk është bërë asgjë në drejtim të funksionalizimit dhe përcaktimit të detyrave të kësaj zyre.

Lartë Administrativ, dy Zëvendës Drejtorë, Zyrtar për Politika, Zyrtar për Financa dhe Grante, si dhe një Zyrtar për Informim në Terren.

Vlen të përmendet se një zyrë e

tillë për çështje të komuniteteve funksionon edhe në kuadër të Zyrës së Presidentit të Kosovës, si dhe që ekziston një ministri e veçantë për Komunitete dhe Kthim. Nuk dihen çartë kompetencat e këtyre zyrave dhe marrëdhëniet e tyre me Ministrinë e Komuniteteve dhe Kthim. Kjo paqartësi e funksioneve të këtyre zyrave ka qenë edhe njëra nga pikat kritikuese të Raportit të Progresit të Komisionit Evropian për Kosovën 2008. Plani i Veprimit të Kuvendit të Kosovës për identifikimin dhe zgjidhjen e sfidave të Raportit të Progresit, parashihet që në tre muajorin e parë të 2009, Komisioni Parlamentar për të Drejtat e Njeriut, Barazi Gjinore, Persona të Pagjetur dhe Peticione, ta mbajë një takim me këto zyra dhe me Ministrinë e Kthimit për t'i qartësuar kompetencat për secilën.

Vazhdim: Nga 1 janari 2009 pagat e pensionistëve dhe ndihmat sociale rriten për 5 €, pagat e shërbyesve civilë rriten për 10%

e shërbyesve civilë që paguhen nga buxheti i Kosovës. Mjetet për pagesat shtesë prej 10% do të merren nga fondi për rritje të pagave dhe do të kushtojnë 13.839.941 €. Nga kjo rritje përfshihen këto kategori: a) të gjitha shtesat

që marrin të punësuarit në Administratën Publike; b) të gjithë të punësuarit që marrin paga fikse e që janë përcaktuar me vendime të veçanta nga ish PSSP-ja, Qeveria, Kuvendi i Kosovës. Këtu bëjnë pjesë agjencionet, rregullatorët, bordet

e pavarura, drejtorët e emëruar nga kryetarët e komunave; c) të punësuarit, pagat e të cilëve janë përcaktuar me ligj të veçantë; dhe d) mësimdhënësit dhe punonjësit e tjerë të arsimit, të cilët kanë përfituar nga procesi i licencimit për vitin 2008.

Qeveria kërkon ndryshimin e Ligjit për Rregullatorin e Energjisë

Në mbledhjen e 49 të Qeverisë së Kosovës, të mbajtur më 9 janar 2009, është marrë vendimi që Projektligji për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit nr.2004/9 për Rregullatorin e Energjisë të procedohet për shqyrtim dhe miratim në Kuvendin e Kosovës. Projektligji ka arritur në Kuvend më 6 mars 2009 dhe ende nuk ka dalë në lexim të parë në Kuvend. Nga miratimi në Qeveri e deri në mbërritjen e tij në Kuvend kanë kaluar dy muaj dhe për këtë vonesë MEM është arsyetuar se i kanë bërë edhe disa ndryshime në projektligj.

Ndryshimet që parashihen me këtë projektligj kanë të bëjnë me kalimin e disa kompetencave, siç janë licencat për ngritjen e kapaciteteve të reja, nga Zyra e Rregullatorit të Energjisë tek Ministria e Energjisë dhe Minierave.

Në anën tjetër, sipas Strategjisë Legjislative 2009, ky projektligj do të duhej që të arrinte për miratim në Qeveri në maj 2009 dhe jo siç ka ndodhur, që të merret vendim për të në janar, kurse në Kuvend të arrijë në mars. Mos respektimi i afateve kohore, të paracaktuara me Strategjinë Legjislative të Qeverisë, ndikon edhe në mos zbatimin e planeve të punës së komisioneve parlamentare të Kuvendit të Kosovës, planet e punës së të cilave janë të bazuara në këtë Strategji.

Ndryshimet që parashihen me këtë projektligj kanë të bëjnë me kalimin e disa kompetencave, siç janë licencat për ngritjen e kapaciteteve të reja, nga Zyra e Rregullatorit të Energjisë tek MEM. Nga ligji janë fshirë nenet 38, 39, 40, 41, 42, 43 dhe 44, të cilat kanë të bëjnë me procedurat e tenderimit për

ndërtimin e kapaciteteve të reja gjeneruese.

Sipas ligjit të mëhershëm, ndërtimi i kapaciteteve të reja do të duhej të bëhej pas lëshimit të autorizimit, apo në rast të mosplotësimit të nevojave për furnizim me energji elektrike, vetëm nëpërmjet lejeve të lëshuara me autorizim të ZRRE-së, pas një procedure tenderuese. Me ligjin e vjetër, procedurat tenderuese do të kryheshin nga ZRRE-ja. Po ashtu detajet për secilin prej tenderëve të shpallur do të bëheshin publike nga ZRRE-ja. Konsideratë do t'i jepej

ofertave me garanci afatgjate dhe, në radhë të parë, do të krijohet një listë e shkurtër e aplikantëve nëpërmjet procedurave të parakualifikimit. Në rast kur brenda afatit të caktuar do të pranohej vetëm një aplikim apo asnjë aplikim, ky afat do të shtyhej nga ZRRE-ja. Po ashtu ZRRE-ja do ta kishte autoritetin për anulimin e një tenderi dhe për hapjen e tenderit të ri.

Me ligjin e ri, Zyra e Rregullatorit të Energjisë nuk ka autoritet për të ndërmarrë procedura tenderimi për ndërtimin e kapaciteteve, rrjeteve, linjave apo sistemeve të tilla të gypave. Ndërtimet e kapaciteteve të reja gjeneruese, rrjeteve të reja të bartjes dhe shpërndarjes së gazit, si dhe linjave të reja direkte të energjisë elektrike dhe sistemeve direkte të gypave për transitin e gazit natyror bazohen në procedurën

e autorizimit të përcaktuar dhe ndërmarrë nga Zyra e Rregullatorit të Energjisë, ose nëse Qeveria e Kosovës, me vendim me shkrim, vendos që ndërtimi i kapaciteteve të tilla, rrjeteve, linjave apo sistemeve të gypave është i nevojshëm për të përmbushur sigurinë e furnizimit të energjisë në Kosovë me procedurën e tenderimit konkurrues të ndërmarrë nga Komiteti Tenderues i Projektit të Energjisë.

Procedura e autorizimit për ndërtimin e objekteve hartohet dhe zbatohet nga Zyra e Rregullatorit të Energjisë edhe me ligjin e ri. Mirëpo, lajmërimi i tenderëve nuk do të bëhet nga ZRRE-ja, por nga Ministria e Energjisë dhe Minierave, e cila do të vendosë në faqen zyrtare të saj edhe detajet e procedurës së tenderimit. Edhe në rastet e shtyrjes së afatit të tenderit, afati mund të zgjatet nga KTPE-ja për një periudhë që nuk tejkalon 60 ditë nga data e vendosjes së njoftimit për zgjatjen e afatit në faqen e internetit të Ministrisë së Energjisë dhe Minierave dhe jo ZRRE-ja. Po ashtu KTPE-ja autorizohet ta anulojë tenderin dhe të shpallë tender të ri, kur është paraqitur vetëm një ofertues ose propozimet e tenderuesve nuk plotësojnë kërkesat e tenderit. KTPE-ja do të informojë me shkrim të gjithë tenderuesit për vendimin përfundimtar për ofertuesin e suksesshëm brenda 3 ditëve të punës pas marrjes së vendimit. Me ligjin e ri secilit ofertues të suksesshëm do t'i sigurohet leja e ndërtimit të objektit, si dhe licenca për aktivitetin gjegjës energjetik.

Miratohet Projektligji për Mjekësinë Ligjore

Qëllimi i këtij ligji është themelimi i Departamentit për Mjekësi Ligjore si organ publik kompetent, përgjegjës për të siguruar ekspertizë mjekoligjore, hetime mjekësore mbi vdekjen, përfshirë eks'humimin (zhvarrosjen) e mbetjeve mortore të shkaktuar si pasojë e konfliktit në Kosovë dhe kthimin e mbetjeve mortore tek familjet e tyre.

Pas themelimit, në këtë departament do të shkrihen edhe Instituti i Mjekësisë Ligjore, i cili funksionon në kuadër të Ministrisë së Shëndetësisë dhe Zyra për Persona të Zhdukur dhe Mjekësi Ligjore, që funksionon në kuadër të Ministrisë së Drejtësisë. Ligji gjithashtu përcakton divizionet dhe sektorët që do të funksionojnë në kuadër të këtij departamenti në Ministrinë e Drejtësisë. Departamenti për Mjekësi Ligjore, i cili do të formohet pas aprovimit të këtij projektligji nga ana e Kuvendit të Kosovës, parasheh edhe marrëdhëniet e ngushta në mes këtij departamenti dhe njësisë përkatëse në kuadër të EULEX-it, ku kërkohet nga EULEX që të ndihmojë në zhvillimin e kapaciteteve vendore në këtë fushë. Kosova ka deficit të

kuadrove për funksionimin normal të një departamenti të tillë në të ardhmen e afërt. Sipas ligjit, funksionimi i këtij departamenti kërkon profesionistë të autopsisë, histopatologë mjekoligjorë, toksikologë mjekoligjorë, antropologë mjekoligjorë, etj.

“Legjislacioni i mëparshëm, i cili e rregullon këtë fushë të shkencës, ka qenë kontradiktor me mjekësinë ligjore”

Në memorandumun shpjegues për arsyeshmërinë e këtij projektligji, Ministria e Drejtësisë shprehet se legjislacioni i mëparshëm, i cili e rregullon këtë fushë të shkencës, ka qenë kontradiktor me mjekësinë ligjore, e cila aplikohet aktualisht për nevojat e gjyqësorit në Republikën e Kosovës, mirëpo nuk e cek për cilat ligje apo akte nënligjore bëhet fjalë.

Sipas deklaratës së Ministrisë së Ekonomisë dhe Financave, zbatimi

i këtij ligji, buxhetit të Kosovës, do t'i kushtojë 2.864.976 € për vitet 2009 – 2010. Për vitin 2009, janë alokuar 772.310 €: 64.260 € për Institutin e Mjekësisë Ligjore dhe 708.050 € për Zyrën për Persona të Zhdukur dhe Mjekësi Ligjore. Me themelimin e departamentit, ku dy njësitë e mësipërme do të shkriheshin në një, nevojiten mjete shtesë buxhetore prej 1.177.678 €, mjete të cilat nuk janë të parapara me buxhetin 2009 dhe me Kornizën Afatmesme të Shpenzimeve 2009-2011.

Aktualisht në Institutin e Mjekësisë Ligjore (MSH) janë të punësuar 10 veta, kurse në Zyrën për Persona të Zhdukur dhe Mjekësi Ligjore (MD) janë të punësuar 57 veta. Kur këto dy njësi organizative do të shkrihen në Departamentin për Mjekësi Ligjore, ky departament do të ketë 72 veta – 67 nga dy departamentet e mësipërme dhe 5 punonjës të rinj. Si rezultat, personeli në MSH-së do të zvogëlohet për 10, kurse ai i MD-së do të rritet për 15. Projektligji ka kaluar leximin e parë në Kuvend në seancën e 12 marsit 2009.

Qeveria kërkon ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për Tregtinë me Naftë dhe Derivatet e Naftës

Projektligji për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit nr.2004/5 për Tregtinë me Naftë dhe Derivateve të Naftës në Kosovë plotëson ligjin aktual, duke shtuar përkufizime të reja dhe duke shtuar nene dhe paragrafë në ligjin ekzistues. Memorandumi shpjegues nuk jep arsye të qarta mbi atë se përse do të duhej të ndryshohej ligji ekzistues që rregullon këtë fushë. Projektligji për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për tregtinë me naftë dhe derivateve të naftës në Kosovë, nuk e ndërron materien e ligjit, por bën disa përmirësime në terminologji; rirregullon disa çështje të funksionit të Këshillit për Rregullimin dhe Vëzhgimin e Sektorit të Naftës në Kosovë; fshin disa nene, pasi që u lihet hapësira që disa çështje të rregullohen me akte nënligjore, etj.

Në shkresën që i bashkëngjitet projektligjit nga Agjencioni për Integritet Evropian pranë Zyrës së Kryeministrit, thuhet se Ligji për Tregtinë me Naftë dhe Derivatet e Naftës në Kosovë nuk i është nënshtruar procesit të kontrollit të përputhshmërisë me *acquis communautaire*, kjo për faktin se

ky ligj është miratuar në vitin 2004, kurse AIE është themeluar në shkurt 2005. Andaj, AIE ka shqyrtuar vetëm harmonizimin e projektligjit me parimet e *acquis* dhe jo dispozitat e ligjit të miratuar më 2004. AIE vlerëson se shtimet dhe ndryshimet që janë bërë në përmbajtjen e Ligjit për Tregtinë me Naftë dhe Derivateve të Naftës në Kosovë nuk cenojnë

Vërejtjet kryesore që Agjencioni për Integritet Evropian i jep për këtë ligj, por dhe për ligjet e tjera, kanë të bëjnë me përmirësime gjuhësore në tekstin në gjuhën angleze. Megjithatë, ky nuk do të duhej të ishte fokusi i punës së Agjencionit.

parimet e përgjithshme të *acquis*, mirëpo, AIE nuk e ka marr mundin që ta shqyrtojë edhe Ligjin e miratuar më 2004, me arsyetimet që cekëm më sipër. Deklarata e AIE për këtë projektligj, por edhe deklaratat e këtij agjencioni për projektligjet e tjera, vërejtjet kryesore që japin, kanë të bëjnë me përmirësimet gjuhësore në

tekstin në gjuhën angleze. Megjithatë, ky nuk do të duhej të ishte fokusi i punës së AIE. Pasi që projektligji nuk e ndryshon në masë të madhe materien e ligjit ekzistues, AIE do të duhej të shqyrtonte kompatibilitetin e tërë ligjit me parimet e *acquis*, kurse MTI, si sponzorizuese e ligjit, do të duhej që të jepte argumente se përse është e nevojshme që të ndryshohen dhe plotësohen disa nene të ligjit.

Sipas deklaratës përcjellëse për këtë ligj për ndikimet eventuale buxhetore, Ministria e Ekonomisë dhe Financave (MEF), konstaton se projektligji nuk do të ketë implikime buxhetore shtesë nga ato mjete që janë ndarë për zbatimin e Ligjit për Tregtinë me Naftë dhe Derivatet e Naftës në Kosovë. Zbatuesi direkt i këtij ligji është Departamenti i Tregtisë në kuadër të Ministrisë së Tregtisë dhe Industrisë, dhe buxheti i këtij departamenti për vitin 2009 është 477.316 €. Projektligji i është dorëzuar Kuvendit të Kosovës më 18 shkurt 2009, një muaj pas marrjes së vendimit nga ana e Qeverisë dhe leximi i parë i tij është bërë në seancën e 12 marsit 2009.

Miratohet Projektligji për Raportimet Financiare të Organizatave të Biznesit

Projektligji për raportimet financiare të organizatave të biznesit është miratuar në Qeveri më 16 janar 2009 dhe i është proceduar Kuvendit për miratim. Mirëpo, në seancën e Kuvendit të Kosovës të datës 26 shkurt 2009 kur parashihej që të bëhej leximi i parë i këtij projektligji, Qeveria pa ndonjë arsye vendos që ta tërheq ligjin mbrapa. Sipas arsyesimeve të mëvonshme, projektligji është tërhequr për shkak të gabimeve që janë evidentuar më vonë në këtë projektligj si dhe për shkak se para miratimit të tij do të duhej që të miratohej Ligji Kundër Shpëlarjes së Parave.

Sipas Strategjisë Legjislative 2009, Ligji Kundër Shpëlarjes së Parave parashihet që të miratohet në Qeveri

në qershor 2009 dhe tek pas miratimit të tij të miratohet Ligji për Raportimet Financiare të Organizatave të Biznesit. Sipas MEF-it, në vitin 2008, për implementimin e ligjit janë ndarë 80 mijë euro. Ligji është përmirësimi i Rregullores së UNMIK-ut 2001/30.

Ky projektligj ka qenë në diskutim që nga vitit 2005, por është refuzuar nga Komisioni i atëhershëm për Buxhet dhe Financa i Kuvendit të Kosovës. Ai është aprovuar pas rishqyrtimeve në vitin 2007 por në prill të vitit 2008 i është kthyer Qeverisë nga Kuvendi. Projektligji për raportimet financiare të organizatave të biznesit rregullon sistemin e raportimit financiar, themelon Këshillin Kosovar për Raportim Financiar dhe parasheh funksionimin e tij.

Ligji parasheh që organizatat e biznesit të regjistruara sipas legjislacionit në fuqi t'i nënshtrohen revizionit të pasqyrave financiare për qëllime të përgjithshme nga auditorët ligjorë. Po ashtu ai parasheh që organizatat e biznesit t'i dorëzojnë kopjet e pasqyrave financiare tek Zyrat e Regjistrimit të Biznesit. Me këtë ligj, organizatat buxhetore që kanë një qarkullim vjetor prej 1 milion eurosh apo më shumë do t'i dorëzojnë një kopje të pasqyrave financiare të revizionuara autoritetit kompetent përkatës dhe një kopje Zyrës për Regjistrimin e Bizneseve. Gjobat për korporatat, që nuk i nënshtrohen ligjit, do të sillen nga 5 mijë deri në 25 mijë euro ndërsa për individët prej 2 mijë deri në 10 mijë euro.



Miratohet Projektligji për Punësimin e Shtetasve të Huaj

Qeveria e Kosovës nëpërmjet ligjit për punësimin e të huajve planifikon të vendos numrin e lejeve për punë që do të jepen për të huajt, në bazë të ecurive në tregun e punës në vend. Qëllimi i ligjit është përcaktimi i kushteve dhe i rregullave për punësimin e shtetasve të huaj. Kështu nëse një kompani e huaja dëshiron ta punësojë dikë, ajo duhet të paraqesë kërkesë në fund të dhjetorit të vitit paraprak te Ministria e Punës dhe Mirëqenies sociale dhe nëse fuqia vendase punëtore nuk ka një person me karakteristikat e kërkuara ajo kompani mund ta punësojë një të huaj.

Ky ligj po ashtu parashikohet ta rregullojë pagesën e taksave nga të huajt, pasi që deri më tani ka pasur një evazion të madh fiskal sidomos

“Deri më tani, të huajt nuk kanë paguar asnjë lloj takse në Kosovë dhe kanë kaluar të pandëshkuar”

nga kompanitë e huaja, të cilat kanë kryer punë në Kosovë. Sipas Ministrisë së Punës dhe Mirëqenies Sociale, deri më tani të huajt nuk kanë

paguar asnjë lloj takse në Kosovë dhe kanë kaluar të pandëshkuar. Ligji po ashtu pritet ta rregullojë lëshimin e lejeve për vetëpunësim për kompanitë ndërkombëtare, të cilat do të investojnë apo marrin punë nga kompanitë publike në Kosovë.

Nga aspekti burokratik, ky ligj paraqet edhe një leje shtesë që të huajt duhet ta marrin për të filluar punën në Kosovë. Sipas planit të punës së Kuvendit të Kosovës për muajin mars, ky projektligj do të dalë për lexim të parë në Kuvend në seancën e 12 marsit 2009.

Miratohet Strategjia Afatmesme e Punës së MAPL-së

Qeveria ka aprovuar Strategjinë Afatmesme të Punës së Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal, në të cilën janë identifikuar objektivat për reformimin e pushtetit lokal dhe decentralizimin; decentralizimin fiskal; ngritjen e kapaciteteve dhe modernizimin e shërbimeve të administratës komunale; rritjen e pjesëmarrjes së qytetarëve në vendimmarrje dhe rritjen e cilësisë së shërbimeve të administratës komunale për qytetarët e Kosovës.

Sipas kësaj strategjie parashihet që në vitet 2009-2012 Komunitat e Kosovës të marrin përgjegjësi më të mëdha qeverisëse. Përgjatë këtyre

viteve, komunitat do të qeverisin edhe më tutje në bazë të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale, të cilin MAP-ja parasheh se do ta ndryshojë, por pa cekur se çfarë ndryshimesh do të bëjë në këtë ligj. Gjithashtu, strategjia specifikon se zgjedhjet e ardhshme lokale do të mbahen në nëntor 2009, fakt i cili nuk është bërë ende i ditur publikisht nga Presidenti i Republikës.

Sipas kësaj strategjie, objektivat kryesor për vitet 2009-2012 janë: 1. Vazhdimi i reformimit të pushtetit lokal dhe decentralizim gjithëpërfshirës funksional në Republikën e Kosovës; 2. Decentralizim fiskal

i qëndrueshëm dhe zhvillimi ekonomik lokal i baraspeshuar; 3. Ngritja e kapaciteteve për udhëheqje moderne, administratë profesionale dhe drejtim kompetent me komunitat; 4. Rritja e pjesëmarrjes së qytetarëve në vendimmarrje dhe në krijimin e politikave në nivel lokal dhe 5. Rritja e vazhdueshme e cilësisë së shërbimeve nëpërmjet bashkëpunimit ndërkomunal, ndërkufitar dhe regjional të komuniteteve me qëllim të arritjes së standardeve evropiane.

Miratohet Udhëzimi Administrativ 01/2009 mbi Kushtet për Zgjedhjen e Lokacionit dhe Ndërtimin e Deponisë së Mbeturinave

Ky udhëzim administrativ bazohet në paragrafin 4 të nenit 27 të Ligjit për Mbeturinat. Ligji për Mbeturinat është miratuar në Kuvendin e Kosovës më 22 korrik 2005, kurse ka hyrë në fuqi më 5 maj 2006 pas shpalljes nga PSSP-ja përmes Rregullores 2006/31. Neni 54 i Ligjit për Mbeturina specifikon që në afat prej 18 muajsh nga hyrja në fuqi e këtij ligji duhet të nxirren të gjitha aktet nënligjore të parapara me këtë ligj. Që nga hyrja në fuqi e ligjit kanë kaluar 32 muaj dhe tek tani është nxjerr ky udhëzim administrativ.

Udhëzimi administrativ ka për qëllim caktimin e kushteve dhe kriterëve për zgjedhjen e lokacionit dhe ndërtimin e deponisë, me qëllim të parandalimit dhe zvogëlimit të ndotjes së ujit, ajrit dhe tokës. Në këtë udhëzim administrativ përfshihen kushtet për zgjedhjen e lokacionit të deponisë; karakteristikat e lokacionit të deponisë; shpjegimet mbi hulumtimin hidro-gjeologjik të lokacionit; kushtet për projektin për ndërtimin dhe shfrytëzimin e lokacionit për deponi; plani për lokacionin e deponisë; plani

inxhinierik; plani i sigurisë për cilësinë e ndërtimit të deponisë; plani i veprimit; plani për monitorimin e deponisë, përfshirë edhe kriteret për ndërtimin e deponisë; dizajnimi dhe ndërtimi i bazamentit të deponisë; dizajnimi dhe ndërtimi i sistemit për grumbullimin e kullimit; sistemi i mbledhjes së gazrave të deponisë; kërkesat për trajtim të kullimit; mbikëqyrja inspektuese; dispozitat ndëshkuese, përfshirë edhe vendimin dhe procedurat e ankesës; si dhe dispozitat kalimtare dhe përfundimtare.

Miratohet Udhëzimi Administrativ nr.02/2009 për Nivelet Maksimale të Lejuara të Shkarkimit dhe Shpërndarjes së Ndotësve në Tokë

Ky udhëzim administrativ bazohet në paragrafin 1 të nenit 30 të Ligjit për Mbrojtjen e Mjedisit. Ligji për Mbrojtjen e Mjedisit është miratuar nga Kuvendi i Kosovës në janar 2003 dhe ka hyrë në fuqi më 15 prill 2003 pas shpalljes nga ana e PSSP-së përmes Rregullores 2003/9. Sipas dispozitave përfundimtare të këtij ligji, parashihet që aktet nënligjore të nxjerrjen në afat prej 12 muajsh nga dita e hyrjes në fuqi të ligjit. Mirëpo, prej hyrjes në fuqi kanë kaluar gati gjashtë vite deri sa është nxjerr kjo urdhëresë administrative. Zbatimin e saj do ta bëjë Ministria e Ambientit dhe Planifikimit Hapësinor.

Qëllimi i kësaj urdhërese është përcaktimi i normave maksimale të lejuara të shkarkimit dhe të shpërndarjes së ndotësve në tokë, të cilët mund të shkaktojnë ndotje

Përkundër afatit 12-mujor të parashikuar me ligj, kanë kaluar gati gjashtë vite deri sa është nxjerrë kjo urdhëresë.

nëse nuk përdoren drejtë. Pjesët tokësore të përcaktuara me këtë udhëzim administrativ janë tokat në afërsi të vendbanimeve të qyteteve të mëdha dhe zonave industriale; tokat e rrugëve me qarkullim trafiku; tokat ku deponohen materiale të

ndryshme të mbeturinave, hirit apo djerrinat; tokat me sasi të mëdha të plehrave minerale dhe organike; tokat e ujitura me ujë të ndotur; kurse në raste të tjera hulumtohet përmbajtja e materieve të rrezikshme dhe të dëmshme, vetitë kimike, fizike dhe biologjike të tokës. Pas analizës bëhet përcaktimi i shkallës së dëmit kimik, fizik dhe biologjik të vetive të tokës. Për të mos humbur cilësinë e tokës dhe funksioneve të saj Ministria ndalon derdhjen apo futjen e materieve në tokë për qëllime ekonomike, e që shkaktojnë zvogëlimin e aftësive ekologjike të tokës. Shpenzimet e hulumtimit të materieve, tokës dhe sanimit i bart shkaktuesi i ndotjes në tokë.

Miratohet Rregullorja për Organizimin dhe Punën e Sekretariatit të Këshillit të Sigurisë së Kosovës

Duke u bazuar në nenin 16.1 të Ligjit për Themelimin e Këshillit të Sigurisë së Kosovës, Qeveria e Kosovës miratoi edhe Rregulloren për Organizimin dhe Punën e Sekretariatit të Këshillit të Sigurisë së Kosovës. Ligji për Këshillin e Sigurisë është miratuar më 13 mars 2008 në Kuvendin e Kosovës, kurse ka hyrë në fuqi më 15 qershor 2008, ditën kur janë dekretuar ligjet e Pakos së Ahtisaarit.

Këshilli i Sigurisë së Kosovës është institucion i sigurisë, formimi

i të cilit parashihet edhe me Pakon e Ahtisaarit. Këshilli është formuar më 10 shkurt 2009, kurse Rregullorja për Organizimin dhe Punën e Sekretariatit të Këshillit të Sigurisë do të shërbejë si dokument për organizimin e takimeve dhe dokumentacionit të Këshillit. Struktura organizative e Sekretariatit propozohet nga Sekretari i Këshillit të Sigurisë dhe duhet të aprovohet nga anëtarët e Këshillit. Sekretari parashihet që të emërohet nga KELP-i dhe t'i raportojë Kryesuesit të Këshillit të Sigurisë, e që njëherit

është Kryeministri i Republikës së Kosovës. Përveç sekretarisë, puna e Këshillit do të mbështetet edhe nga Qendra e Situatave dhe Komisioni i Zbulimit (Inteligjencës). Anëtarë të këshillit të Sigurisë së Kosovës sipas ligjit do të jenë: Kryeministri (i cili njëherit është edhe kryesues); dy Zëvendës-Kryeministat; Ministri i FSK-së, Ministri i MPJ-së, Ministri i MPB-së, Ministri i MD-së, Ministri i MEF-it dhe Ministri i MKK-së.



Miratohet Raporti Vjetor i Punës së Qeverisë së Kosovës për Vitin 2008

Në mbledhjen e 9 janarit 2009, Qeveria e Kosovës miratoi Raportin Vjetor të Punës së Qeverisë së Kosovës për Vitin 2008. Ky raport përmban 225 faqe dhe në të janë të përfshira aktivitetet njëvjeçare të Zyrës së Kryeministrit dhe të gjitha ministrive. Raporti ka qenë i publikuar në të gjitha gazetatat ditore, për tri ditë radhazi.

Më 20 janar 2009, njëzetë ditë

pas marrjes së vendimit 02/49, Kryeministri i Republikës së

Pozita e ka lavdëruar, kurse opozita kritikuar, duke thënë se raporti përmban detaje të panevojshme.

Kosovës ka prezantuar Raportin Vjetor të Punës para deputetëve

të Kuvendit të Kosovës, seancë e cila ka zgjatur tre ditë. Një numër i madh i deputetëve të Kuvendit të Kosovës kanë komentuar raportin e Qeverisë së Kosovës, pozita duke e lavdëruar kurse opozita duke e kritikuar. Një nga kritikantët më të mëdha që i është dhënë përmbajtjes së këtij raporti është edhe ajo se raporti përmban detaje të panevojshme dhe ka mundur të jetë më përmbledhës.

Ndryshohet Vendimi 23/48 për Ndërtimin e Shtatores së Bill Klinton

Përmes vendimit 8/51, Qeveria ndryshon vendimin 23/48. Vendimi 23/48 ende nuk është publikuar me arsyetimin se ky vendim, dhe të gjitha vendimet e tjera të mbledhjes së 48 të Qeverisë, nuk është nënshkruar nga ana e Kryeministrit dhe si i tillë ai nuk mund të publikohet në faqen zyrtare të internetit, sikurse janë publikuar vendimet e të gjitha mbledhjeve të tjera të Qeverisë. Në anën tjetër, nuk mund të merret vendim për ndryshimin e një vendimi i cili nuk ka hyrë në fuqi, ngase vendimet e kryeministrit hynë në fuqi në momentin e nënshkrimit nga ana e tij.

Në mbledhjen e 48 mbajtur më 24 dhjetor 2008, Qeveria e Kosovës

ka marrë vendim që të ndajë mjete në vlerë prej 25.000 € për ndërtimin e shtatores së ish-Presidentit amerikan Bill Klinton. Mjetet do

Qeveria ka vendosur ta ndryshojë vendimin, i cili nuk ka hyrë në fuqi, pasi që nuk është nënshkruar nga Kryeministri.

të ndahen nga Fondi "Rezervat e Paparashikuara" dhe do të derdhen në xhirologarinë e shoqatës "Miqte e Amerikës – Miqtë e Bill Klintonit". MEF-i ngarkohet për zbatimin e këtij vendimi.

Sipas përfaqësuesve të kësaj shoqate, mjetet janë ndarë nga MEF dhe shoqata në fjalë i ka bartur mjetet tek skulptori nga Shqipëria i cili e ka punuar shtatoren. Skulptura e presidentit amerikan Bill Klinton, sipas kësaj shoqate, është përfunduar para shumë kohësh, mirëpo nuk ka mundur që të tërhiqet për shkak të mungesë së mjeteve që janë nevojitur për kompensim të punës së artistit i cili e ka punuar këtë skulpturë. Shtatorja pritet që të vendoset në Prishtinë më 19 gusht 2009, ditë e cila korrespondon me ditëlindjen e 63 të ish-presidentit amerikan Bill Klinton.

Themelohet Komisioni për Menaxhimin e Fondit për Mbështetjen e Mediave Minoritare, Multietnike dhe Grupeve të Tjera

Duke u bazuar në Rregulloren e fondit për mbështetjen e mediave minoritare, multietnike dhe grupeve tjera të veçanta, e cila është miratuar kohë më parë, Qeveria ka vendosur për themelimin e komisionit për menaxhimin e këtij

fondi. Në përbërje të këtij komisioni do të jenë gjashtë anëtarë: kryesues do të jetë përfaqësuesi i Zyrës për Komunikim Publik, një përfaqësues i Ministrisë së Kthimit dhe Komuniteteve, përfaqësuesi i Këshillit të Mediave të Shkruara,

përfaqësuesi i Institutit të Mediave, përfaqësuesi i IREX-it dhe përfaqësuesi i RTK-së. Mjetet e ndara për këtë fond janë 200.000 €. Komisioni do të vendosë kriteret për mënyrën e ndarjes së këtyre mjeteve.

Qeveria ndan 20.000 € për renovimin e tërësishëm të shtëpisë së dëshmorit të kombit Hasan Ramadani

Pas kërkesës së bërë nga Organizata e Veteranëve të Luftës në Podujevë, Qeveria ka vendosur që të ndaj një shumë prej 20.000€ për renovimin e tërësishëm të shtëpisë së

familjarëve të dëshmorit Hasan Ramadani, i vrarë nga forcat serbe në vitin 1994. Mjetet financiare për renovimin e shtëpisë së dëshmorit ndahen nga Fondi Rezervë i MEF-it dhe derdhen në xhirrolloarinë e

Shoqatës së Veteranëve të Luftës së UÇK-së. Kosova ende nuk ka ndonjë ligj që përcakton kriteret se kujt duhet ndarë mjete, sa dhe si të bëhet kontrolli i mjeteve të ndara.

Ndahen 100.000 € për renovimin e shtëpive të dëmtuara në lagjen "Kroi i Vitakut" në Mitrovicë

Mjetet financiare prej 100.000€ ndahen nga Fondi Rezervë i MEF-it. Menaxhimi dhe administrimi i këtij projekti do të bëhet nga një

komision ndërqeveritar i përbërë nga përfaqësues të ZKM-së, MKK-së, MAPL-së, MEF-it dhe Kuvendit Komunal të Mitrovicës.

Ndahen 100.000 € për sanimin e dëmeve të shkaktuara nga trazirat e fundit në pjesën veriore të Komunës së Mitrovicës

Gjatë incidenteve të fillimit të janarit të vitit 2009, në Mitrovicë janë dëmtuar disa lokale dhe shtëpi të shqiptarëve. Në ditët e fundit të dhjetorit në veri të qytetit gjithashtu janë shënuar disa djegie të veturave dhe lokale të shqiptarëve pas një incidenti ndëretnik në atë pjesë të qytetit, kur një i ri serb ishte therur me thikë nga dy të rinj shqiptarë nga Gjakova.

Qeveria e Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 9 janar të vitit 2009, kishte vendosur që të ndajë 100.000 €, me qëllim të sanimit të dëmeve nga trazirat e fundit në pjesën veriore të Mitrovicës. Mjetet janë ndarë nga Fondi Rezervë i MEF-it dhe i janë alokuar Ministrisë për Kthim e cila duhet të përcaktojë kriteret, procedurat dhe afatet për ndarjen

e këtyre mjeteve, megjithatë ende asgjë nuk është bërë në këtë drejtim dhe, sipas bashkëbiseduesve, ekziston mendimi që këto mjete të barten nga Ministria e Kthimit tek Komuna e Mitrovicës me qëllim që kjo e fundit të menaxhojë me këto mjete, mirëpo deri më tani nuk ka asgjë zyrtare rreth kësaj.

gap | monitor

i vendimeve të Qeverisë së Kosovës

PËRMBLEDHJE

Në muajin janar të vitit 2009, Qeveria e Kosovës ka mbajtur katër mbledhje të rregullta: mbledhjet 49, 50, 51 dhe 52. Në të katër mbledhjet janë marrë gjithsej 18 vendime: 4 vendime në mbledhjen e 49, 5 vendime në mbledhjen e 50, 7 vendime në mbledhjen e 51 dhe dy vendime në mbledhjen e 52.

1. Vendimet nga mbledhja e 49 e Qeverisë së Kosovës, më 9 janar 2009:

- 1.1 Vendimi 02/49 për Miratimin e Raportit Vjetor të Punës së Qeverisë së Kosovës për vitin 2008;
- 1.2 Vendimi 03/49, i cili ia lejon Zyrës së Komuniteteve, e cila funksionon në kuadër të Zyrës së Kryeministrit, që të punësojë personel shtesë;
- 1.3 Vendimi 04/49 për miratimin e Projektligjit për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit nr.2004/9 për Rregullatorin e Energjisë;
- 1.4 Vendimi 05/49 për ndarjen e mjeteve financiare në vlerë prej 100.000 euro, me qëllim të sanimit të dëmeve të shkaktuara nga trazirat e fundit në pjesën veriore të Komunës së Mitrovicës;

2. Vendimet nga mbledhja e 50 e Qeverisë së Kosovës, më 16 janar 2009:

- 2.1 Vendimi 02/50 për plotësimin e pozitive vakante të mbetura pas tërheqjes së anëtarëve ndërkombëtarë nga Komisioni për Emërime të Larta Publike (KELP), me qëllim të funksionimit të duhur dhe efektiv të KELP-it, deri në pritje të finalizimit dhe hyrjes në fuqi të ligjeve të Kuvendit të Kosovës që do të rregullojnë organizimin e Shërbimit Civil të Kosovës, dukë përfshirë edhe emërimin e zyrtarëve të lartë;
- 2.2 Vendimi 03/50 për miratimin e udhëzimit administrativ mbi Kushtet për Zgjedhjen e Lokacionit dhe Ndërtimin e Deponisë së Mbeturave;
- 2.3 Vendimi 04/50 për miratimin e udhëzimit administrativ për Nivelet Maksimale të lejuara të Shkarkimit dhe Shpërndarjes së Ndotësve në Tokë;
- 2.4 Vendimi 05/50 për miratimin e Projektligjit për Raportimet Financiare të Organizatave të Biznesit;
- 2.5 Vendimi 06/50 për miratimin e Projektligjit për punësimin e shtetasve të huaj në Kosovë.

3. Vendimet nga mbledhja e 51 e Qeverisë së Kosovës, më 23 janar 2009:

- 3.1. Vendimi 02/51 që nga 1 janari 2009 të rriten për 5 euro pagesat për kategoritë e skemave sociale dhe pensionale në kuadër të Ministrisë së Punës dhe Mirëqenies Sociale; si dhe të rriten për 10% rrogat për të gjithë të punësuarit e Administratës Publike;
- 3.2. Vendimi 03/51 për miratimin e Rregullores nr.01/2009 për Organizimin dhe Punën e Sekretariatit të Këshillit të Sigurisë së Kosovës;
- 3.3. Vendimi 04/51 për miratimin e Projektligjit për Themelimin e Departamentit për Mjekësi Ligjore;
- 3.4. Vendimi 05/51 për miratimin e Projektligjit për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit nr.2004/5 për Tregtinë me Naftë dhe Derivate të Naftës në Kosovë;
- 3.5. Vendimi 06/51 për ndarjen e mjeteve financiare në vlerë prej 100.000 €, me qëllim të renovimit të shtëpive të dëmtuara në lagjen Kroi i Vitakut në Mitrovicë;
- 3.6. Vendimi 07/51 për ndarjen e mjeteve financiare në vlerë prej 20.000 € për renovimin e tërësishëm të shtëpisë së dëshmorit të kombit Hasan Ramadani;
- 3.7. Vendimi 08/51 për ndryshimin e vendimit nr.23/48.

4. Vendimet nga mbledhja e 52 e Qeverisë së Kosovës, më 30 janar 2009:

- 4.1. Vendimi 02/52 për miratimin e Strategjisë Afatmesme të Punës së MAPL-së 2009-2012;
- 4.2. Vendimi 03/52 për themelimin e Komisionit për Menaxhimin e Fondit për Mbështetjen e Mediave Minoritare, Multietnike dhe grupeve të tjera të veçanta.

GAP Monitor është publikim i përmuajshëm i Institutit për Studime të Avancuara GAP. Ky numër është përgatitur nga: Agron Demi, agron@insitutigap.org; Rudina Heroi, rudina@insitutigap.org; Shemsedin Aliu, shemsedin@insitutigap.org dhe Kreshnik Berisha, keka@insitutigap.org.

Insituti GAP është Think Tank kosovar, që punon në ngushtimin e hendekut në mes qeverisjes dhe qytetarëve të Kosovës, në shërbim të avancimit të shoqërisë kosovare.

Rr. Nëna Terezë 41/29, 10000 Prishtinë, Kosovë | +381 38 224 145 | monitor@insitutigap.org | www.insitutigap.org